



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr. *01-104-61278*

Datë: 20.09.2018

N J O F T I M

Ju njoftojmë se ka përfunduar procedura e evidentimit të atyre që kanë aplikuar për dëmshpërblim nga vërshimet e datës 15-16 Gusht 2018.

Kryetari i Komunës së Suharekës së bashku me Shefat e Grupeve të Asamblistëve të Kuvendit të Suharekës në takimin e mbajtur me datë 19.09.2018, vendosi që dëmet për Amvisëri të kompensohen në vlerën prej 80% të shumës së vlerësuar nga komisioni përkatës për vlerësim.

Nga data **24.09.2018** (e Hënë) deri më **27.09.2018** (e Mërkurë) , qytetarët të cilët janë evidentuar në listat e publikuara, të sjellin dokument identifikimi (kopje të letërnjoftimit) dhe numrin e llogarisë bankare të konfirmuar nga Banka.

Aplikantët duhet të paraqiten në zyrën Numër 1, pranë Drejtorisë për Shërbime Publike, Mjedis dhe Emergjencë.

Të bashkangjitur gjeni listat e përfituesve.

